

## **MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, BASHKIA DURRËS**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Durrës, me objekt “Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare” për periudhën viti 2011, 2012 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së Nr. 178, datë 31.12.2013.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr.712/7, datë 31.12.2013, Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse, i janë dërguar z. Vangjush Dako, Kryetar i Bashkisë, Durrës.

K Kontrolli i Lartë i Shtetit ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

1. DTTV në bashkëpunim me Sektorin e Buxhetit të marrë masa për propozim në KB për përmirësim në paketën fiskale pasi nuk janë të saktësuara procedurat për të vepruar në drejtim të cilësimit të taksës së ndërtesës dhe tarifave për pastrimin, ndriçimin, parkimin si dhe nivelin e tyre, për:

- subjektet që mbyllin aktivitetin ose e pezullojnë atë,
- subjektet me aktivitet tregëti karburanti dhe shërbim lavazhi,
- subjektet me aktivitet ndërtimi në kategorinë “Subjekte ndërtuese” duke përcaktuar gjithashtu që tarifa e pastrimit të përfshijë të gjitha subjektet ndërtuese apo vetëm ato subjekte për periudhën që kryejnë punime.

**Menjëherë**

2. Duke qenë se realizimi i të ardhurave në raport me planifikimin ka mosrealizime të theksuara, DTTV Durrës, të marrë masa që në procesin e përgatitjes së projektbuxhetit të shfrytëzohen në maksimum burimet me qëllim që plani i të ardhurave të jetë sa më real dhe i arkëtueshëm.

**Menjëherë**

3. Nga DTTV Durrës të merren masa për informimin brenda afateve ligjore të tatimpaguesit për nivelin e Taksave dhe Tarifave që do të zbatohen për vitin ushtrimor në vazhdim, sipas përcaktimeve në VKB.

**Menjëherë**

4. Nga DTTV Durrës të hartohet dhe miratohet një program pune për evidentimin e saktë të subjekteve që operojnë në territorin e bashkisë dhe të fillojnë menjëherë procedurat e regjistrimit të subjekteve të paregjistruara si dhe të llogariten e njoftohen detyrimet përkatëse për taksat e tarifave vendore.

**Menjëherë**

5. Nga DTTV Durrës të merren masat përkatëse dhe të ndiqen procedurat sipas Rregullores së Brendshme për ngritjen e një komisioni të përbërë nga specialistë të fushës për verifikimin e pasurive dhe përcaktimin e sipërfaqeve të ndërtesave mbi të cilat llogariten detyrimet për taksën e ndërtesës sipas kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore“, neni 24.

**Menjëherë**

6. Nga DTTV Durrës të kërkohet në rrugë zyrtare nga administratori i programit software përmirësimi i raporteve që gjeneron programi duke bërë të mundur grupimin e subjekteve sipas aktivitetit faktik që ushtrojnë, reflektimin e menjëhershëm të ndryshimeve që pësojnë subjektet dhe llogaritjen automatike të gjobave dhe interesave për mospagimin e detyrimeve në afat pasi, në gjendjen aktuale, hasen vështirësi në punën e përditëshme të punonjësve të sektorit të regjistrimit dhe kontrollit.

#### **Menjëherë**

7. Nga auditimi janë konstatuar të meta e mangësi në vlerësimin e xhiros së subjekteve për efekt të llogaritjes së taksave e tarifave vendore, si rezultat i mungesës së të dhënave sidomos nga DR Tatimore, Durrës mbi dinamikën e subjekteve, vecanërisht ndryshimin e statusit dhe kalimin në subjekt me TVSH. Me qëllim vlerësimin sa më real të treguesve të subjekteve, nga DTTV të merren masa në rrugë institucionale për sigurimin e bashkëpunimit me institucionet e tjera për sigurimin e informacionit, në veçanti me DRT Durrës, në zbatim të Programit të Punës nr. 11105, datë 15.05.2012 ndërmjet palëve, në lidhje me:

-Listën e subjekteve që janë regjistruar si tatimpagues të biznesit të vogël me tvsh me xhiro vjetore 5-8 milion lekë, sipas VKM nr. 1058, datë 21.10.2009 “Për përcaktimin e kufirit minimal të regjistrimit në tvsh”.

-Listën e subjekteve me aktivitet “profesione të lira” që janë regjistruar në tvsh si tatimpagues të biznesit të vogël, sipas VKM nr. 149, datë 03.03.2010 për tvsh.

#### **Menjëherë**

8. Sektori i kontrollit të marrë masa të menjëhershme për hartimin, zbatimin dhe realizimin e programeve të kontrollit në zbatim të legjislacionit për Taksat dhe Tarifat Vendore, plotësimin dhe sistemimin e dokumentacionit sipas zonave dhe objektit të kontrollit, dokumentimin dhe qarkullimin e mallrave, sensibilizimin për deklarimin vullnetar të xhiros si dhe arkëtimin e detyrimeve për të gjitha subjektet nën juridiksionin e DRT, Durrës.

#### **Menjëherë**

9. Nga DTTV, në bashkëpunim me Burimet Njerëzore, të kërkohet në mbledhjen më të afërt të Këshillit Bashkiak që të përcaktohet dhe saktësohet mënyra e pagesës së agjentëve tatimorë në rajone. Të rishikohen kontratat e Bashkisë Durrës me agjentët tatimorë pasi nuk kanë fuqi ligjore dhe si të tilla nuk prodhojnë efekte juridike. Të vlerësohet mundësia e lidhjes së marrëveshjeve të reja me agjentë tatimor, duke i dhënë përparësi institucioneve shtetërore ose private që kanë eksperiencë të mëparshme ose të ngjashme në këtë fushë. Në marrëveshjet që mund të lidhen duhet të parashikohen penalitete në rast të mos përmbushjes së objektivave në realizimin e treguesve të vendosur nga institucioni si dhe mënyra e monitorimit.

#### **Menjëherë**

### **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

Nga Bashkia Durrës të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit me vlerën **25,121,216 lekë** në mënyrë analitike si më poshtë:

1. Vlera prej **1,409,200 lekë** nga subjekti ■■■■■ për mos llogaritje dhe mosarkëtim të detyrimeve tatimore në lidhje me taksën e pasurisë. *Trajtuar në faqen nr.92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**Menjëherë**

2. Vlera prej **227,610 lekë** të arkëtohen detyrimet tatimore për mosrespektim të kontratave të qirasë në tregun e fruta perimeve për zënie të hapësirës publike pa paguar detyrimet, pa i kaluar sektorit të kontabilitetit. *Trajtuar në faqen nr.89-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**Menjëherë**

3. Vlera prej **234,428 lekë** nga subjektet ■■■■■ për mos llogaritje dhe mosarkëtim të detyrimeve tatimore në lidhje me taksën e pasurisë. *Trajtuar në faqen nr. 93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**Menjëherë**

4. Vlera prej **647,580 lekë** detyrime tatimore për 7 subjekte të cilat kanë rezultuar me nipte dhe aktiv në DRT Durrës, dhe të pa regjistruara në DTTV B. Durrës, pa ju dërguar nga zyra njoftim detyrimi. *Trajtuar në faqen nr.100 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**Menjëherë**

5. Vlera prej **1,870,068 lekë** të arkëtohen si detyrime tatimore nga 8 subjekte, që janë regjistruar si tatim pagues të biznesit të vogël me tvsh me xhiro vjetore 5-8 milionë lekë dhe subjektet që janë regjistruar si tatim pagues të biznesit të vogël, në DRT Durrës dhe pa u regjistruar në zyrën e taksave dhe tarifave vendore B. Durrës, apo dërguar njoftim detyrimin tatimore nga zyra, për vitet 2011 – 2012. *Trajtuar në faqen nr.102 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**Menjëherë**

6. Vlera prej **10,405,000 lekë** të arkëtohen detyrimet tatimore për taksën e pastrimit dhe gjelbërimit, të pa paguara, nga periudha e ngritjes së kantierit të ndërtimit deri në momentin e dorëzimit nga subjekti pranë Bashkisë Durrës të kërkesës për leje shfrytëzimi në 49 raste. *Trajtuar në faqen nr.94-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**Menjëherë**

7. Vlera prej **1,211,614 lekë** nga 24 subjekte të identifikuar me aktivitet pa leje, për detyrime tatimore të pallogaritura dhe paarkëtuara për vitin 2012. *Trajtuar në faqen nr. 83 – 87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**Menjëherë**

8. Vlera prej **437,720 lekë** të arkëtohen si detyrime tatimore nga 3 subjekte, me aktivitet argjendari lloto & lojra fati, të pajisura me nipte të cilat nuk kanë deklaruar apo aplikuar detyrimet pa i kaluar sektorit të regjistrimit nga sektori i kontrollit. *Trajtuar në faqen nr.88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**Menjëherë**

9. Vlera prej **3,275,486 lekë** të arkëtohen pagesat ndaj agentëve tatimorë rajonal për vitet 2011 – 2012, pasi për to nuk ka asnjë Vendimin të Këshillit Bashkiak për pagesë komisioni 5% nga shumatat e arkëtuara nga taksat e tarifave të popullatës. *Trajtuar në faqen nr.55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**Menjëherë**

10. Vlera prej **1,500,700 lekë** për subjektet që kanë mbyllur ose pezulluar aktivitetin 6/mujorin e parë të vitit dhe nuk ju janë llogaritur taksat e tarifave si: Taksa e gjelbërimit, Tarifa e ndriçimi, Taksa mbi ndërtesën, Taksa e tabelës, Tarifa e pastrimit dhe Largimit të mbeturinave, Tarifa e

parkimit për Krijim fluks automjetesh. *Trajtuar në faqen nr.19 – 24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**Menjëherë**

**11.** Vlera prej **634,800 lekë** e Taksave dhe e Tarifave për subjektet për të cilat nuk u janë llogaritur detyrimet saktë sipas niveleve të përcaktuara në Vendimet e Këshillit Bashkiak. *Trajtuar në faqen nr.28 – 35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**Menjëherë**

**12.** Vlera prej **1,561,000 lekë** nga subjektet e prodhimit sipas pasqyrës Nr.1 (bashkëlidhur RP të Auditimit) të cilave për vitin 2011, Taksa mbi biznesin ju është llogaritur sipas Vendimit të KB nr. 195, datë 18.01.2010, më i ulët se niveli i Taksës mbi Biznesin sipas përcaktimit në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” me ndryshimet, aneksin 5. *Trajtuar në faqen nr.37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**Menjëherë**

**13.** Vlera prej **208,250 lekë** për subjektet që për vitin 2011 dhe 2012 Taksat mbi Biznesin nuk janë llogaritur saktë sipas niveleve të përcaktuara në Vendimin e KB nr. 195, dt.18.01.2010 dhe nr. 39 datë 17.01.2012. *Trajtuar në faqen nr. 37 – 38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**Menjëherë**

**14.** Vlera prej **1,497,760 lekë** nga subjektet me aktivitet Hoteleri për të cilat nuk është llogaritur saktë Taksa mbi Pasurinë. *Trajtuar në faqet nr. 25 – 28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**Menjëherë**

### **C. MASA DISIPLINORE**

**I.** Mbështetur në nenin 25, të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe pikën 1 e 2 të VKM nr. 306, datë 13.06.2000 “Për disiplinën në shërbimin civil”, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

**a) “Largimi nga shërbimi civil”, neni 25, pika 3 germa “d” për:**

**1.** ■■■■■ me detyrë ish-drejtor i Taksave dhe Tatimeve Vendore Durrës, për periudhën 01.01.2011 deri me 31.06.2012, për:

-Programim dhe planifikim me mangësi të tarifave dhe taksave në Bashkinë e Durrësit, kryesisht ato të popullatës.

-Mungesë në organizim për mos ushtrim kontrollesh në terren dhe mungesë bashkëveprimi me sektorin e regjistrimit, veprime që bien në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e Taksave Vendore”, neni 5, Llogaritja e detyrimit tatimor të tatim paguesit, udhëzimin nr. 655/1, datë 06.02.2007 pika 5, ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 për QKR neni 22, Detyrimi për regjistrim pika 2 germa a, ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” neni 6, Detyrimi Tatimor pika 1 dhe 2, neni 40 pika 5, mos regjistrimi nuk e çliron një person nga pagesa e detyrimit tatimor, ose përmbushja e detyrimeve të tjera tatimore.

-Mosrealizim i të ardhurave për tarifatat në Bashkinë e Durrësit, kryesisht në taksat dhe tarifatat e popullatës për vitet 2011-2012.

-Në kundërshtim me ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore”, neni 16 pika 2, pika 4, si dhe në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” me ndryshimet neni 11 pika 5.

-Mungesë organizimi nga sektori i kontrollit për vendosjen e sipërfaqeve të pasurive të paluajtshme për taksën e ndërtesës në shkelje të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore“ neni 24 si dhe të Vendimeve të KB nr.195, dt.18.01.2010 dhe nr.39 dt.17.01.2012 pika 1.2.

-Llogaritja e detyrimeve për sipërfaqet e pasurive të paluajtshme në bazë të nivelit të shfrytëzimit të këtyre pasurive, në kundërshtim me ligjin nr.9632, dt. 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, me ndryshimet, neni 20 pika 1.

**b) “Kalimi në një detyrë të një niveli tjetër apo klase më të ulët për një periudhë një vjeçare”, neni 25 pika 3 germa ç” per:**

1. ■■■■■ me detyrë inspektor i sektorit të kontrollit, për:

-Moszbatim të Udhëzimeve të Kryetarit të Bashkisë Durrës nr.83, datë 07.07.2012 dhe nr.85, datë 07.07.2012 “Për konfiskimin e mallrave të pashoqëruar me dokumenta tatimore”, veprime që bien në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në RSH”

-Mosushtrim kontrollesh në terren e duke mos kaluar detyrimet sektorit të rregjistrimit,veprime që bien në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, Për sistemin e Taksave Vendore neni 5, Llogaritja e detyrimit tatimor të tatim paguesit, udhëzimin nr. 655/1, datë 06.02.2007 pika 5, ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 për QKR neni 22, Detyrimi për regjistrim pika 2 germa a, ligjin Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” neni 6 Detyrimi Tatimor pika 1 dhe 2, neni 40 pika 5, mos regjistrimi nuk e çliron një person nga pagesa e detyrimit tatimor, ose përmbushja e detyrimeve të tjera tatimore.

-Vendosja e sipërfaqeve të pasurive të paluajtshme për taksën e ndërtesës në shkelje të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore“ neni 24 si dhe të Vendimeve të Këshillit Bashkiak nr.195, dt.18.01.2010 dhe nNr.39 dt.17.01.2012 pika 1.2.

2. ■■■■■ me detyrë inspektor i sektorit të kontrollit, për:

-Moszbatim të Udhëzimeve të Kryetarit të Bashkisë Durrës Nr. 83, datë 07.07.2012 dhe Nr. 85, datë 07.07.2012 “Për konfiskimin e mallrave të pashoqëruar me dokumenta tatimor”

Veprime që bien në kundërshtim me ligjin Nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”

-Mosllogaritje të taksës mbi pasurinë e paluajtshme në kundërshtim me ligjin Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, neni 20, Taksa mbi pasurine e paluajtshme, pika 1. Udhëzimi Nr. 655/1 datë 06.02.2007 dalë në zbatim të ligjit. Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 195 datë 18.01.2010 pika 1.2 Taksa mbi Pasurinë e Paluajtshme , 1.2.1 taksa mbi ndërtesën, germa a), vërtetimin e pronësisë.

-Mosushtrim kontrollesh në terren dhe mungesë bashkëveprimi me sektorin e rregjistrimit,veprime që bien në kundërshtim me ligjin Nr. 9632, datë 30.10.2006, Për sistemin e Taksave Vendore neni 5, Llogaritja e detyrimit tatimor të tatim paguesit, Udhëzimin Nr. 655/1, datë 06.02.2007 pika 5, Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 për QKR neni 22, Detyrimi për regjistrim pika 2 germa a, ligjin Nr. 9920, datë 19.05.2008 “ Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” neni 6 Detyrimi Tatimor pika 1 dhe 2, neni 40 pika 5, mos regjistrimi nuk e çliron një person nga pagesa e detyrimit tatimor, ose përmbushja e detyrimeve të tjera tatimore.

3. ■■■■■ me detyrë drejtor i Burimeve Njerëzore, për:

-Pagesën ndaj agentëve tatimor rajonal për vitet 2011 – 2012, pa Vendim të Këshillit Bashkiak për pagesë komisioni 5% nga shumata e arkëtuara nga taksat e tarifave të popullatës, veprime që bien në kundërshtim me ligjin Nr. 9632 datë 30.10.2006 Për Sistemin e Taksave Vendore, i ndryshuar, dhe Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.131 datë 26.12.2008 “Për disa ndryshime në strukturën dhe rregulloren e Bashkisë së Durrësit” për pagesën e agentëve tatimore rajonal.

4. ■■■■■ me detyrë inspektor i sektorit të kontrollit, për:

-Mosllogaritje të taksës mbi pasurinë e paluajtshme në kundërshtim me ligjin Nr. 9632, datë 30.10.2006 Për Sistemin e Taksave Vendore, i ndryshuar, neni 20, Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, pika 1. Udhëzimi Nr. 655/1 datë 06.02.2007 dalë në zbatim të ligjit. Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 195 datë 18.01.2010 pika 1.2 Taksa mbi Pasurinë e Paluajtshme , 1.2.1 taksa mbi ndërtesën, germa a), vërtetimin e pronësisë.

-Mosushtrim kontrollesh në terren dhe mungesë bashkëveprimi me sektorin e regjistrimit, veprime që bien në kundërshtim me ligjin Nr. 9632, datë 30.10.2006, Për sistemin e Taksave Vendore neni 5, Llogaritja e detyrimit tatimor të tatim paguesit, Udhëzimin Nr. 655/1, datë 06.02.2007 pika 5, Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 për QKR neni 22, Detyrimi për regjistrim pika 2 germa a, ligjin Nr. 9920, datë 19.05.2008 “ Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” neni 6 Detyrimi Tatimor pika 1 dhe 2, neni 40 pika 5, mos regjistrimi nuk e çliron një person nga pagesa e detyrimit tatimor, ose përmbushja e detyrimeve të tjera tatimore.

5. ■■■■■ me detyrë inspektor i sektorit të kontrollit,

6. ■■■■■ me detyrë inspektor i sektorit të kontrollit, për:

-Mosllogaritje të taksës mbi pasurinë e paluajtshme në kundërshtim me ligjin Nr. 9632 datë 30.10.2006 Për Sistemin e Taksave Vendore, i ndryshuar, neni 20, Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, pika 1. Udhëzimi Nr. 655/1 datë 06.02.2007 dalë në zbatim të ligjit.

Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 195 datë 18.01.2010 pika 1.2 Taksa mbi Pasurinë e Paluajtshme , 1.2.1 taksa mbi ndërtesën, germa a), vërtetimin e pronësisë.

-Mosushtrim kontrollesh në terren dhe mungesë bashkëveprimi me sektorin e regjistrimit, veprime që bien në kundërshtim me ligjin Nr. 9632, datë 30.10.2006, Për sistemin e Taksave Vendore neni 5, Llogaritja e detyrimit tatimor të tatim paguesit, Udhëzimin Nr. 655/1, datë 06.02.2007 pika 5, Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 për QKR neni 22, Detyrimi për regjistrim pika 2 germa a, ligjin Nr. 9920, datë 19.05.2008 “ Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” neni 6 Detyrimi Tatimor pika 1 dhe 2, neni 40 pika 5, mos regjistrimi nuk e çliron një person nga pagesa e detyrimit tatimor, ose përmbushja e detyrimeve të tjera tatimore.

-Vendosja e sipërfaqeve të pasurive të paluajtshme për taksën e ndërtesës në shkelje të ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “ Për Sistemin e Taksave Vendore “ neni 24 si dhe të Vendimeve të Këshillit Bashkiak Nr.195 dt.18.01.2010 dhe Nr.39 dt.17.01.2012 pika 1.2.

7. ■■■■■ me detyrë inspektor i sektorit të kontrollit, për:

-Mosushtrim kontrollesh në terren dhe mungesë bashkëveprimi me sektorin e regjistrimit, veprime që bien në kundërshtim me ligjin Nr. 9632, datë 30.10.2006, Për sistemin e Taksave Vendore neni 5, Llogaritja e detyrimit tatimor të tatim paguesit, Udhëzimin Nr. 655/1, datë 06.02.2007 pika 5, Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 për QKR neni 22, Detyrimi për regjistrim pika 2 germa a, ligjin Nr. 9920, datë 19.05.2008 “ Për Procedurat Tatimore në Republikën e

Shqipërisë” neni 6 Detyrimi Tatimor pika 1 dhe 2, neni 40 pika 5, mos regjistrimi nuk e çliron një person nga pagesa e detyrimit tatimor, ose përmbushja e detyrimeve të tjera tatimore.

-Vendosja e sipërfaqeve të pasurive të paluajtshme për taksën e ndërtesës në shkelje të ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “ Për Sistemin e Taksave Vendore “ neni 24 si dhe të Vendimeve të Këshillit Bashkiak Nr.195 dt.18.01.2010 dhe Nr.39 dt.17.01.2012 pika 1.2.

-Për llogaritjen e detyrimeve për Taksat e Tarifat për vitet 2011- 2012 rezultoi se për disa subjekte nuk janë llogaritur detyrimet dhe për disa raste të tjera detyrimet nuk janë llogaritur saktë sipas niveleve të përcaktuara në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.195 datë 18.01.2010.

Në shkelje të ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “ Për Sistemin e Taksave Vendore “ neni 24 si dhe të Vendimeve të Këshillit Bashkiak Nr.195 dt.18.01.2010 dhe Nr.39 dt.17.01.2012 pika 1.2

**8.** ■■■■■ me detyrë inspektor i sektorit të kontrollit, për:

-Mosllogaritje të taksës mbi pasurinë e paluajtshme në kundërshtim me ligjin Nr. 9632 datë 30.10.2006 Për Sistemin e Taksave Vendore, i ndryshuar, neni 20, Taksa mbi pasurine e paluajtshme, pika 1. Udhëzimi Nr. 655/1 datë 06.02.2007 dalë në zbatim të ligjit.

Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 195 datë 18.01.2010 pika 1.2 Taksa mbi Pasurinë e Paluajtshme , 1.2.1 taksa mbi ndërtesën, germa a), vërtetimin e pronësisë.

-Mosushtrim kontrollesh në terren dhe mungesë bashkëveprimi me sektorin e regjistrimit, veprime që bien në kundërshtim me ligjin Nr. 9632, datë 30.10.2006, Për sistemin e Taksave Vendore neni 5, Llogaritja e detyrimit tatimor të tatim paguesit, Udhëzimin Nr. 655/1, datë 06.02.2007 pika 5, Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 për QKR neni 22, Detyrimi për regjistrim pika 2 germa a, ligjin Nr. 9920, datë 19.05.2008 “ Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” neni 6 Detyrimi Tatimor pika 1 dhe 2, neni 40 pika 5, mos regjistrimi nuk e çliron një person nga pagesa e detyrimit tatimor, ose përmbushja e detyrimeve të tjera tatimore.

-Vendosja e sipërfaqeve të pasurive të paluajtshme për taksën e ndërtesës në shkelje të ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “ Për Sistemin e Taksave Vendore “ neni 24 si dhe të Vendimeve të Këshillit Bashkiak Nr.195 dt.18.01.2010 dhe Nr.39 dt.17.01.2012 pika 1.2.

**c) “Vërejtje me paralajmërim”, neni 25 pika 3 germa “b” per 10 (dhjete) punonjes:**

**1.** ■■■■■ me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore Durrës, për periudhën 01.07.2012 deri me 31.12.2012, për:

-Mungesë organizimi e shoqëruar me mosrealizim i të ardhurave për tarifatat e taksat në Bashkinë e Durrësit, kryesisht në taksat dhe tarifatat e popullatës për vitin 2012.

Veprime këto që nuk përputhen me kërkesat e që përbëjnë shkelje të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore “ neni 24 si dhe të Vendimeve të Këshillit Bashkiak Nr.195 dt.18.01.2010 dhe Nr.39 dt.17.01.2012 pika 1.2.

**2.** ■■■■■ me detyrë inspektor i sektorit të kontrollit,

**3.** ■■■■■ me detyrë inspektor i sektorit të kontrollit, për:

-Mos ushtrim kontrollesh në terren dhe mungesë bashkëveprimi me sektorin e regjistrimit, veprime që bien në kundërshtim me ligjin Nr. 9632, datë 30.10.2006, Për sistemin e Taksave Vendore”, neni 5, Llogaritja e detyrimit tatimor të tatim paguesit, Udhëzimin nr. 655/1, datë 06.02.2007 pika 5, ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 për QKR neni 22, Detyrimi për regjistrim pika 2 germa a, ligjin Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 6, Detyrimi Tatimor pika 1 dhe 2, neni 40 pika 5.

4. ■■■■■ me detyrë specialist i Sektorit të të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifat për:

-Mosllogaritjen e detyrimeve për Taksat e Tarifat për vitet 2011- 2012 për disa subjekte të cilëve nuk u janë llogaritur detyrimet dhe për disa raste të tjera detyrimet nuk janë llogaritur saktë sipas niveleve të përcaktuara në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.195 datë 18.01.2010 dhe Nr.39 dt.17.01.2012

-Llogaritja e detyrimeve për sipërfaqet e pasurive të paluajtshme në bazë të nivelit të shfrytëzimit të këtyre pasurive,në kundërshtim me Ligjin Nr.9632,dt. 30.10.2006 “ Për sistemin e Taksave Vendore ” me ndryshimet Neni 20 pika 1.

5. ■■■■■ me detyrë specialist e Sektorit të të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifat, për:

-Mosllogaritjen e detyrimeve për Taksat e Tarifat për vitet 2011- 2012 për disa subjekte të cilëve nuk u janë llogaritur detyrimet dhe për disa raste të tjera detyrimet nuk janë llogaritur saktë sipas niveleve të përcaktuara në Vendimin e Këshillit Bashkiak r.195 datë 18.01.2010 dhe Nr.39 dt.17.01.2012

-Vendosja e sipërfaqeve të pasurive të paluajtshme për taksën e ndërtesës në shkelje të ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “ Për Sistemin e Taksave Vendore “ neni 24 si dhe të Vendimeve të Këshillit Bashkiak Nr.195 dt.18.01.2010 dhe Nr.39 dt.17.01.2012 pika 1.2.

-Llogaritja e detyrimeve për sipërfaqet e pasurive të paluajtshme në bazë të nivelit të shfrytëzimit të këtyre pasurive,në kundërshtim me Ligjin Nr.9632,dt. 30.10.2006 “ Për sistemin e Taksave Vendore ” me ndryshimet Neni 20 pika 1.

6. ■■■■■ me detyrë Administrator i Tregut Agrobujqësor,

7. ■■■■■ me detyrë arkëtare e Tregut Agrobujqësor,

8. ■■■■■ me detyrë inspektor i Tregut Agrobujqësor, për:

-Mosrespektim të kontratave së qirasë në tregun e fruta perimeve për zënie të hapësirës publike në lidhje me pagesën e detyrimeve, veprime që bien në kundërshtim me ligjin Nr. 9632 datë 30.10.2006 Për Sistemin e Taksave Vendore, i ndryshuar, neni 9, llojet e taksave vendore, pika 7 taksa për zënie e hapësirave publike, neni 14 Pagesa, Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 195 datë 18.01.2010 pika 2 Taksa e Përkoshme, 2.2 taksa e përkohshme e tregut.

9. ■■■■■ me detyrë jurist pranë Drejtorisë Taksave dhe Tarifave Vendore Durrës, për:

-Llogaritja e detyrimeve për sipërfaqet e pasurive të paluajtshme në bazë të nivelit të shfrytëzimit të këtyre pasurive,në kundërshtim me Ligjin Nr.9632,dt. 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” me ndryshimet neni 20 pika 1, si dhe në kundërshtim me Vendimet e Këshillit Bashkiak Bashkia Durrës Nr.195, datë 18.01.2010 dhe Nr.39, datë 17.01.2012 dhe ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore”. Neni 16 pika 2. pika 4. si dhe në kundërshtim me Ligjin nr. 9632 ,datë 30.10.2006 “ Për Sistemin e Taksave Vendore “ me ndryshimet, neni 11 pika 5.

10 ■■■■■ me detyrë shëf i sektorit të kontrollit, për:

-Mungesë organizimi për mosushtrim kontrollesh në terren dhe mungesë bashkëveprimi me sektorin e regjistrimit, veprime që bien në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, Për sistemin e Taksave Vendore neni 5, Llogaritja e detyrimit tatimor të tatim paguesit, Udhëzimin nr. 655/1, datë 06.02.2007 pika 5, ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 për QKR neni 22, Detyrimi për regjistrim pika 2 germa a, ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” neni 6 Detyrimi Tatimor pika 1 dhe 2, neni 40 pika 5, mos regjistrimi



nuk e çliron një person nga pagesa e detyrimit tatimor, ose përmbushja e detyrimeve të tjera tatimore.

-Mungesë organizimi nga sektori i kontrollit për vendosjen e sipërfaqeve të pasurive të paluajtshme për taksën e ndërtesës në shkelje të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore “ neni 24 si dhe të Vendimeve të Këshillit Bashkiak nr.195 dt.18.01.2010 dhe nr.39 dt.17.01.2012 pika 1.2.

**d)“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, për një periudhë një vjeçare”, neni 25 pika 3 gërma “c” per:**

1. [REDAKTUAR] me detyrë specialiste e Sektorit të të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifat, për:

-Moslllogaritje e detyrimeve sipas niveleve të përcaktuara në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.195, dt.18.01.2010 dhe Nr. 39, datë 17.01.2012 për Taksën Vendore mbi Biznesin e Vogël për vitin 2011 dhe 2012 në disa subjekte të biznesit të vogël në kundërshtim me Ligjin Nr. 9632, dt. 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore ” me ndryshimet, neni 20, pika 1.

2. [REDAKTUAR] me detyrë specialiste e Sektorit të të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifat, për:

-Moslllogaritje e detyrimeve për Taksën Vendore mbi Biznesin e Vogël për vitin 2011 dhe 2012 rezultoi për një numër të vogël subjektesh nuk janë llogaritur saktë sipas niveleve të përcaktuara në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.195,dt.18.01.2010 dhe Nr.39 datë 17.01.2012.

Veprimi që bien në kundërshtim me Ligjin Nr.9632, dt. 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” me ndryshimet neni 20 pika 1.Gjithashtu veprimet bien në kundërshtim me Vendimet e Këshillit Bashkiak Bashkia Durrës Nr.195, datë 18.01.2010 dhe Nr.39, datë 17.01.2012.

3. [REDAKTUAR] me detyrë sekretare e sekretarisë teknike, për:

-Moslllogaritje e detyrimeve për Taksën e Përkohshme të Gjelbrimit e Tarifës së Pastrimit, veprime që bien në kundërshtim me ligjin Nr. 9632 datë 30.10.2006 Për Sistemin e Taksave Vendore, i ndryshuar, neni 33 Taksat e Përkohshme dhe neni 35 Tarifat Vendore dhe administrative dhe Vendimet e Këshillit Bashkiak pika 2 Taksa e Përkohshme, 2.1 Taksa e Përkohshme e Gjelbrimit dhe Aneksi 2 Kategoritë e Bazës dhe nivelet e Tarifës së Pastrimit.

II. Referuar konstatimeve, mangësive dhe shkeljeve të dispozitave ligjore në fuqi të konstatuara në RP të Auditimit, Kryetari i Bashkisë, Durrës të analizojë rast pas rasti dhe të percaktojë llojin e masave administrative dhe disiplinore për punonjësit e mëposhtëm:

1. [REDAKTUAR] me detyrë punonjës i Policisë Bashkiake Durrës,

2. [REDAKTUAR] me detyrë punonjës i Policisë Bashkiake Durrës,

3. [REDAKTUAR] me detyrë punonjës i Policisë Bashkiake Durrës,

4. [REDAKTUAR] me detyrë punonjës i Policisë Bashkiake Durrës, për:

-Moszbatim të Udhërave të Kryetarit të Bashkisë Durrës Nr. 83, datë 07.07.2012 dhe Nr. 85, datë 07.07.2012 “Për konfiskimin e mallrave të pashoqëruar me dokumenta tatimor”

Veprime këto që bien në kundërshtim me ligjin Nr. 9920, datë 19.05.2008” Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”. *Trajtuar në faqen 53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për ish-punonjësit [REDACTED] dhe [REDACTED] nuk rekomandohet masë pasi nuk janë më në marrëdhënie pune me institucionin.

*Shënim:* Auditimi u krye nga audituesit Taulant Stermasi p/grupi, Aqif Klosi, Din Zenelaj dhe Vladimir Rizvani, më tej u shqyrtua nga K/audituesi z. Albert Thoma, Drejtori i Drejtorisë Juridike, Sigurimit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Departamentit znj. Albana Agolli si dhe u verifikua si praktikë nga Sekretari i Përgjithshëm znj. Luljeta Nano.

**Mbi zbatimin e rekomandimeve:**

Bashkia Durrës ende nuk ka kthyer përgjigje për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme të lëna nga auditimi, pasi rekomandimet e KLSH-se kane shkuar ne subjekt me daten 06.01.2014.

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**